

## **Shtyhet thirrja për mobilitete studentësh dhe stafi të UPT-së në kuadër të marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+ në University of Oradea, Rumani.**

Në kuadër të programit Erasmus+ dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është shtyrë thirrja për aplikime për mobilitete për studentë dhe staf të Universitetit Politeknik të Tiranës, në University of Oradea.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për Traineeship
  - Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.
- Shkëmbimin e stafit për mësimdhënie/trajnim.
  - Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Drejtoritë në UPT.

### **Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Studentët duhet të jenë të regjistruar në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës ose në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, në vit të fundit të studimeve, Master.

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- Për studentët: Traineeship, 2.5 – 3 muaj, semestri i II, 2024 - 2025;
- Për stafin: Teaching/Training – 5 ditë (+ 2 ditë udhëtim), semestri i II, 2024 - 2025.

### **Numri total i studentëve: 1**

### **Numri total i stafit: 1**

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:**

- CV;
- Kopje e pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj\* (Rumanisht ose Anglisht);
- Dokumenti Learning Agreement.

*\*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze (ose rumune), ku niveli minimal i kërkuar për studentët është B1. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

*Dokumenti "Learning Agreement" te seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga Drejtuesi i Departamentit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

*Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement”, ju lutemi klikoni më poshtë:*

[learning-agreement-traineeships-oct21\\_en.docx \(live.com\)](#)

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për për stafin:**

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e pasaportës;
- Aprovim nga Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe konfirmim nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t’u kryer në universitetin pritës\*;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës\*\*;
- Dokumenti Mobility Agreement (Staff Mobility for Teaching/Training”) \*\*\*.

*\*Plani i mobilitetit për mësimdhënie ose trajnim, si dhe periudha e propozuar e mobilitetit për stafin, duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe të konfirmohet/firmoset nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore ku aplikanti bën pjesë.*

*\*\*Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobiliteteve si staf në universitetin pritës, paraprakisht duhet të kenë aprovimin nga universitetin pritës (Dekan/ titullar departamenti ose program studimi/ profesor), për kryerjen e aktivitetit gjatë periudhës së mobilitetit. Ai/ ajo do të duhet t’ju dërgojë një dokument paraprak aprovues, të cilin do të duhet ta bashkangjisni me dokumentet e tjera të kërkuara për aplikimin tuaj.*

*\*\*\* Mobility Agreement për Teaching/Training për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga Drejtuesi i Njesisë Bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

*Personi që do të kryejë mobilitetin për mësimdhënie ose trajnim, pas përfundimit të mobilitetit, duhet të paraqesë një raport mbi aktivitetet e departamenti përkatës si dhe te Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit.*

**Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: 15 janar 2025, ora 12.00**

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al) dhe [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al)